



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 4 , datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI
MBROJTËSE TË PËRKOHSHME NË RAST EMERGJENCE,
SUBJEKTIT “MINISTRIA E KULTURËS”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim për veprimtari mbrojtëse të përkohshme në rast emergjence, subjektit “Ministria e Kulturës”, me vendndodhje, “Ura e Matit”, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujor: Lumi Mat

Koordinatat e vendodhjes së pritës në (KRGJSH):

-X=477032.77; Y=4618286.06; Z=18;

-X=477035.57; Y=4618295.58; Z=19;

-X=477314.29; Y=4618311.51; Z=16;

-X=477315.47; Y=4618304.17; Z=16;

2. Në përfundim të punimeve të largohen të gjitha materialet dhe barierat e krijuara në shtratin e lumit duke rruajtur seksionin e mëparshëm të lumit natyral në aksin e urës, sipër dhe poshtë saj;
3. Në vazhdimësi të këtyre masave të hartohet projekti i ndërhyrjes afatgjatë për mbrojtjen e urës, duke konsideruar ndër masat komplekse edhe zhvendosjen e pikës së marrjes së ujit nga kanali ujitës, me një zgjidhje që nuk zvogëlon seksionin e kalimit të ujit në aksin e urës, sipër dhe poshtë saj;
4. Të monitorohet në vazhdimësi efekti i këtyre ndërhyrjeve morfologjin e lumit në aksin e urës, sipër dhe poshtë saj;
5. Ngarkohet “Ministria e Kulturës” dhe Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, për zbatimin e këtyre rekomandimeve;
6. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

